



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Lënda: Kthim Përgjigje

Në vijim të shkresës Tuaj të datës 17.08.2024, administruar me nr. 17274 prot datë 26.08.2024 në bashkinë Shkodër, ku është kërkuar informacion në lidhje me:” *projektin e propozuar për ndërtimin e një kulle Rozafa Tower*”.

Bazuar në Ligjin nr. 44/2015 “ *Kodi i Procedurës Administrative*” i ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 “ *Për vetë qeverisjen vendore*” i ndryshuar, ligjin nr. 107/2014 “ *Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit*” i ndryshuar, Ligjin nr. 119/2014 “ *Për te Drejtën e Informimit*” sqarojme se:

Sa përket pyetjes nr.1, theksojmë se në Bashkinë Shkodër nuk është realizuar ndonjë aplikim në sistemin e-leje për objektin e kërkuar për informacion “Rozafa Tower”.

Në lidhje me pyetjet në vijim të kërkeses suaj, ju sqarojmë se në mungesë të kërkesës/aplikimit (*dokumentacionit tekniko-ligjor*) drejtuar bashkisë Shkodër , në mbështetje të parashikimeve ligjore të ligjit nr.107/2014 “ *Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit* “ i ndryshuar, si dhe VKM 408/2015 “ *Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*“ i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi nuk kemi informacion.

Aktet ligjore të sipër cituara kanë të përcaktuara detyrimet dhe funksionet e Njësive Vendore dhe ato të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Ndër të tjera sa i përket Planit të Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5 datë 16.10.2017, i rishikuar me Vendim të KKT nr. 9 datë 28.12.2020 , sqarojmë se tek ky Plan përshkruhen të gjitha kushtet, kriteret e përcaktuara sipas Njësive Strukturore të emertuara.

Për informacione të tjera lutemi te orientoheni në faqen web <https://planifikimi.gov.al> .

**KRYETAR**

**Benet BECI**